

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

ASC-10-0005

Në lëndën SCEL-06-021 " [REDACTED] "

[REDACTED]
[REDACTED]
Ankuesi nr. 4/ Apeluesi

Ferizaj

vs.

Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit

E Paditura

e përfaqësuar nga UNMIK, Kompleksi TSS
Prishtinë

Kolegji i Apelit pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, sipas apelit të ankuesit nr. 4 kundër vendimit të Trupit Gjykses të DHPGJS-së të datës 27 tetor 2009, pas seancës vendim-marrëse të mbajtur me 17 gusht 2010 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

Apeli hedhet poshtë si i papranueshëm.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 27 tetor 2009, Trupi Gjykses i DHPGJS-së ka lëshuar një vendim në lëndën SCEL-06-021 me të cilin e ka refuzuar ankesën e Ankuesit si të papranueshme, konform Nenit 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Trupi Gjykses ka

II

cekur se Ankuesi kishte kërkuar futjen në listë të punëtorëve adekuat lidhur me listën e përkohshme të punëtorëve adekuat të botuar nga e Paditura lidhur me Ndërmarrjen Shoqërore Drita/Sutjeska/ Ferizaj. Pastaj, Trupi Gjykes ka cekur se dita e fundit e paraqitjes së ankesës pranë DHPGJS-së ka qenë 26 shtatori 2006, kurse ankuesi e ka paraqitur ankesën e tij me 10 tetor 2009. Vendimi i qe dërguar Ankuesit/ Apeluesit me 29 tetor 2009.

Me 12 janar 2010, DHPGJS e ka pranuar përmes faksit, nga Gjykata Supreme e Kosovës, ankesën e Ankuesit/Apeluesit, e cila është paraqitur në Gjykatën Supreme të Kosovës me 2 dhjetor 2009.

Me 18 mars 2010, Kolegji i Apelit e ka urdhëruar Ankuesin/Apeluesin që të qartësoi se pse apeli nuk është paraqitur brenda afatit të paraparë me nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, me që vendimi i atakuar i qe dorëzuar Ankuesit /Apeluesit me 29 tetor 2009 dhe se afati për paraqitje të apelit kishte kaluar me 28 nëntor 2009. Ankuesi/ Apeluesi gjithashtu ishte vënë në dijeni lidhur me Nenin 117 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ 4/77, me ndryshime).

Me 26 mars 2010, Ankuesi/Apeluesi iu ka përgjigjur urdhrit dhe ka dërguar një kopje të vërtetimit postar të datës 9 tetor 2009, e cila nuk ka të bëjë me apelin por me ankesën. Në parashtresën e tij Ankuesi/Apeluesi nuk ka dhënë qartësim se pse apeli kundër vendimit të kundërshtuar është paraqitur pas kalimit të afatit. Ai nuk ka kërkuar që ti lejohet kthimi në gjendje të mëparshme.

Arsyetimi Ligjor:

Apeli është i pasafatshëm andaj edhe duhej të hidhej poshtë si i papranueshëm.

Sipas Nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, apeli kundër ndonjë vendimi të DHPGJS-së mund të paraqitet me shkrim pranë Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e pranimit të aktvendimit.

III

Vendimi i qe dërguar Ankuesit/ Apeluesit me 29 tetor 2009, andaj, sipas Nenit 20 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, afati për paraqitje të apelit kundër vendimit kishte mbaruar me 28 nëntor 2009. Ankuesi/Apeluesi nuk ka treguar asnjë, e posaçërisht, arsye të justifikueshme për mos paraqitjen e apelit me kohë.

Edhe po të pranohej apeli, ai do të ishte i pabazuar.

Sipas Nenit 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 më kërkesë të personit të pakënaqur, (...) lista e punëtorëve adekuat i nënshtrohet rishqyrtimit nga DHPGJS-së; ankesa duhet të paraqitet në DHPGJS brenda 20 ditëve pas publikimit përfundimtar në media. Dita e fundit për paraqitje të ankesës në DHPGJS ka qenë 26 shtatori 2006 dhe Ankuesi e ka paraqitur ankesën me 10 tetor 2009. Pra, Trupi Gjykses ishte i detyruar ta refuzonte ankesën si të papranueshme konform Nenit 28.3 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, lidhur me Nenet 28.2 (d) dhe 67.1 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 dhe Nenit 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Taksat Gjyqësore:

Konform Rregullave Plotësuese Procedurale të Dhomës së Posaçme lidhur me tarifatat Gjyqësore në fuqi që nga 10 marsi 2010 (në bazë të Nenit 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6) procedurat në lëndët lidhur me Listën e Punëtorëve Adekuat (Neni 67 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 dhe procedurat përkatëse ankimore) janë pa pagesë. Andaj, vendimi mbi shpenzimet gjyqësore nuk është marrë.

Richard Winkelhorf, Gjyqtar Kryesues, EULEX	nënshkruar
Torsten Koschinka, Gjyqtar, EULEX	nënshkruar
Elija-Liisa Helin, Gjyqtare, EULEX	nënshkruar
Tobias Lapke, Regjistruer, EULEX	nënshkruar